



A.nr. 497/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj - Demi anëtare me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 497/2026 të datës 05.05.2026, të parashtruar nga ankuesi A.K, kundër organit të punësimit: Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike, në çështjen juridik “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr. 497/2026, e datës 05.05.2026, e parashtruar nga ankuesi A.K.

A r s y e t i m

Ankuesi, A.K (me tej referuar vetëm ankuesi), më datë 05.05.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr. 497/2026, me pretendimet ankimore lidhur me konkursin RN00019469, e datës 18.03.2026, për pozitën “ Drejtor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve”, në Zyrën e Kryeministrit, Drejtues i Mesëm, i paraparë vetëm për komunitetet jo shumicë, të zhvilluar nga Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 02.06.2026 e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike ndërsa kjo e fundit, më datë 05.06.20256, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A.nr.497/2026 të datës 05.05.2026; drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e

letërnjoftimit për ankuesin A.K; Vendimin me numër protokolli 57/2026, i datës 30.04.2026, i nxjerr nga Zyrtari i Lartë në Departamentin për Menaxhimin e Zyreve Publike; Diplomë me numër protokolli 031/24, e datës 05.11.2024, për A.K, e lëshuar nga IBCM; Pasqyra e trustit, për A,K, për periudhën nga data 23.07.2004, deri me datën 15.04.2025; Diplomë me numër protokolli 073/18, e datës 25.05.2018, për A.K; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.06.2026, dërguar nga R.K, për I.P; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 497/2026, e datës 25.06.2026; Aplikacioni i A.K; Konkursi me numër reference RN00019649, i datës 18.03.2026; Lista e Aplikantëve; Përshkrim i detyrave të punës për pozitën “ Drejtor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve” ; Certifikatat e ankuesit A.K; Vendimi me numër protokolli 03, i datës 24.10.2025; Akt Emërimi me numër protokolli 01/2025, i datës 12.05.2025, për ankuesin A.K; Certifikatat e ankuesit; Kontratë e punës e datës 11.01.2016; Kontratë e punës e datës 01.01.20215; ; Kontratë e punës e datës 01.01.2013; ; Kontratë e punës e datës 04.01.2012; ; Kontratë e punës e datës 01.01.2011; Certifikatat e ankuesit A.K; Letër referencë e datës 23.10.2018;Kopje e letërnjoftimit për ankuesin A.K; Pasqyra e trustit, për A,K, për periudhën nga data 23.07.2004, deri me datën 30.03.2026; Vete deklaratë e datës 24.03.2026; Emalin e datës 29.06.2026, dërguar nga I.P, për R.K.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse;

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike, më datë 18.03.2026, ka shpallur konkursin me referencë RN00019469, e datës 18.03.2026, për pozitën “Drejtor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve”, në Zyrën e Kryeministrit, Drejtues i Mesëm, i cili është paraparë vetëm për komunitetet jo shumicë numri i kërkuar (1) pozitë. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 19.03.2026 deri me 17.04.2026, e në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi.

Ankuesi me datë 05.05.2026, parashtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore lidhur me refuzimin e aplikacionit, sipas vendimit me numër protokolli 57/2026, të datës 30.04.2026, me arsyetimin se gjatë aplikimit kam dorëzuar kontratën e punës dhe përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Project Manager”, nga e cila rezulton se kam ushtruar këtë funksion që nga data 01.12.2020, e në vazhdim, duke përmbushur mbi tri vite përvojë punë menaxheriale, me tej ankuesi pretendon anulimin e vendimit me numër protokolli 57/2026, lidhur me refuzimin e aplikacionit për pozitën “ Drejtor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve”, rivlerësimin e aplikimit tim me përputhje ,e dokumentacionin e dorëzuar dhe përfshirjen e tij në fazën e mëtejshme të procedurës së rekrutimit.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me të cilin është përcaktuar se:...12. *Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative.. si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimin në Shërbimin Civil me të cilin shprehimisht parashihet se: Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve, në rast të*

pakënaqësive me procesin e rekrutimit ka të drejtë të parashtoj ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, ndërsa, në rastin konkret ankesa është parashtruar me datë 05.05.2026, prandaj nga njoftimi përmes emailit të datës 29.06.2026, dërguar nga I.P, Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, është njoftuar se lidhur me konkursin për pozitën “Drejtor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve”, është përfunduar vetëm faza e verifikimit paraprak, ndërsa fazat e tjera të procedurës së rekrutimit ende nuk janë zhvilluar, andaj mbi bazën e këtij konstatimi, ankuesi ankesën e ka parashtruar në Këshill si të parakohshme, ashtu siç e përcaktojnë dispozitat ligjore në fuqi, andaj mbi bazën e kësaj rezultoni së ankesa e ankuesit është e parakohshme, dhe si e tillë është e palejueshëm në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L 048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendoi si në dispozitivin e këtij.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë-Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA: A.nr. 497/2026

Rushit Kajtazi

Eshref Shabani

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, A.K;
- Udhëheqësit të Divizionit në DZHRI-DMZP, në Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së